



A.nr.2095/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës–Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj Demi, kryetare, dhe Malsore Gashi Bajraktari dhe Eshref Shabani, anëtarë, me Merlinda Ramaj, në cilësinë e procesmbajtëses, në procedurë sipas ankesës me numër A.nr.2095/2025, të datës 31.12.2025, të parashtruar nga ankuesi K.T, nga Prishtina, të cilin me autorizim e përfaqëson Avokate Myrvete Hashani Jashari nga Prishtina, kundër organit të punësimit: Komunës së Prishtinës, në çështjen juridike “*shkelje e të drejtës në pagë*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.2 dhe 1.4 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe në mbështetje të Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 11.06.2026, nxjerrë, këtë:

V E N D I M

I. Refuzohet si e pabazuar ankesa me numër A.nr.2095/2025, e datës 31.12.2025, e parashtruar nga ankuesi K.T.

II. Detyrohet Udhëheqësi i Njësisë së Burimeve Njerëzore të Komunës së Prishtinës që në pajtim me pikëpamjet juridike si në arsyetimin e këtij vendimi të anuloj Aktin e emërimit të ankuesit Nr. 01-112-1257, i datës 19.11.2024.

III. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi, duhet të njoftohet lidhur me veprimet e ndërmarra në zbatim të këtij vendimi ashtu siç përcaktohet në pikën II të dispozitivit.

A r s y e t i m

Nëpunësi civil K.T. (në tekstin e mëtejme referuar: Ankuesi), me datë 31.12.2025, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Përgjigjes në kërkesë me numër referencë 7910/25, të datës 22.12.2025, të Menaxherit të Burimeve Njerëzore të Komunës së Prishtinës, lidhur me mos kompensim e pagës sipas koeficientit të pagës 5.1-GJ33, duke iu referuar Aktit të Emërimit të lëshuar datë 19.11.2024.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (tutje referuar Kolegji i Këshillit) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 08.01.2026 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë në Komunën e Prishtinës, ndërsa kjo e fundit më datë 21.01.2026 ka dërguar përgjigjen në ankesë se bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (në tekstin e mëtejshëm referuar: Kolegji i Këshillit) për vendosje meritore administroi këto prova: Ankesa me numër protokolli 8147/2025 të datës 31.12.2025, e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Përgjigjen në kërkesë me numër reference të datës 22.12.2025 të Menaxherit të Burimeve Njerëzore të Komunës së Prishtinës; Akt Emërimit me Nr. 01-112-1257 të datës 19.11.2024; Akt Emërimit me Nr. 01-112-1237 të datës 08.05.2024; Vendimin A.nr.1954/2025 të KPMSHCK-së; Kopjen ID-së ankuesit; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 08.01.2026; Përgjigjen në ankesë e datës 21.01.2026; Lista e pagave; Vendimi 14-112/02-0201950/23 i datës 04.10.2023, për periudhën nga data 12.10.2023 deri më 11.04.2024, sipas Vendimit 14-112/02-43522/24, të datës 29.03.2024, për periudhën nga data 12.04.2024 deri më 11.10.2024, dhe Vendimi 14-112/02-0133832/24 i datës 11.10.2024, për periudhën nga data 12.10.2024 deri më 11.04.2025.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, bazuar në vlerësimin e hollësishëm të çdo prove veç e veç dhe të gjitha provave të marra së bashku, si dhe bazuar në rezultatin tërësor të shqyrtimit administrativ, ka gjetur se pretendimet ankimore të ankuesit *janë të pabazuara, sepse:*

Gjendja e çështje

Nga administrimi i shkresave të lëndës rezulton se:

- Ankuesi është i punësuar në Komunën e Prishtinës dhe së i njëjti sipas Akt Emërimit 01 nr.112-1237 të datës 08.05.2024, ushtronte pozitën “Zyrtar për Arkiv SHC-1043”, në kuadër të Drejtorisë së Urbanizmit, ndërsa, organi i punësimit sipas nenit 102 paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë, me datë 19.11.2024 i ka lëshuar Aktin e Emërimit me Nr.01-112-1257, ashtu që, pozitën e ankuesit “Zyrtar për Arkiv I, AD/210”, e ka klasifikuar në Kategorinë Profesional 2, më klasë të pagës GJ33 dhe koeficient të pagës 5.1.

- Ankuesi, më datë 23.09.2025 i është drejtuar Njesisë së Burimeve Njerëzore të Komunës së Prishtinës, me kërkesë për kompensim material sipas koeficientit të pagës 5.1-GJ33, duke iu referuar Aktit të Emërimit të lëshuar datë 19.11.2024. Po ashtu, ankuesi në kërkesën në fjalë pretendon se është duke u paguar sipas koeficientit 4.50, GJ41-4 Profesional 3, ndërsa sipas shkresave të lëndës dhe thënieve në ankesë organi i punësimit ka heshtur, duke mos dhënë përgjigje në kërkesën e ankuesit të datës 23.09.2025.

- Kundër heshtjes administrative të Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore, ankuesi ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimin ankimor se i njëjti është duke u dëmtuar financiarisht, pasi që pavarësisht faktit se organi i punësimit ia ka lëshuar Aktin e Emërimit me koeficient 5.1, i njëjti nuk është duke u kompensuar sipas koeficientit të ri, e me kërkesë që organi i punësimit të zbatoj aktin e emërimit me Nr. 01-112-1257 të datës 19.11.2024 dhe t'i bëjë kompensimin sipas koeficientit 5.1, duke përfshirë kompensimin në mënyrë retroaktive që nga data 19.11.2024. Kërkon të aprovohet ankesa të obligohet Komuna e Prishtinës të zbatoj akt emërimit e datës 19.11.2024 dhe kompensimin sipas koeficientit 5.1 nga muaji dhjetor nga dita e nënshkrimit të akt emërimit duke llogaritur edhe rritjen e koeficientit të pagës tani në 6.1.

- Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës më datë 12.12.2025 ka nxjerr Vendim me numër A.nr.1954/2025, me të cilin ka aprovuar ankesën e ankuesit duke e detyruar Njesisë e Burimeve Njerëzore të Komunës së Prishtinës të shqyrtoj kërkesën e datës 01.10.2025 të ankuesit.

- Menaxheri i Burimeve Njerëzore i Komunës së Prishtinës, me qëllim të zbatimit të Vendimit A.nr.1954/2025 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 21.12.2025,

përmes përgjigjes në kërkesë ka shqyrtuar kërkesën e datës 01.10.2025 të palës ankuese, duke e njoftuar të njëjtën se kanë adresuar në Thesar akt emërimit për ekzekutim të pagave sipas akt emërimeve. Mirëpo, kanë marr udhëzime nga Thesari që paraprakisht të përgatitet Rregullorja për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës e cila është parakusht për procedimin e akt emërimeve dhe pagesave, kështu që ka njoftuar se janë në procedurë respektivisht në fazën finale të hartimit të Rregullores për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës dhe pas miratimit të rregullores do të krijohen kushte për procedim të mëtejshëm të pagave sipas akt emërimeve.

Pretendimet ankimore

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me bazë pretendimi për mos realizim të koeficientit të pagës sipas Aktit të Emërimit Nr. 01-112-1257 të datës 19.11.2024. Kërkon që aprovohet ankesa dhe të detyrohet organi i punësimit që të zbatojë dhe ekzekutoj Aktin e Emërimit Nr. 01-112-1257, të datës 19.11.2024 dhe ti kompensojë pagën sipas koeficientit të pagës 5.1.

Vlerësimi i Kolegjit

Kolegji i Këshillit mbështetur në mandatin kushtetues dhe ligjor lidhur me sigurimin e respektimit të rregullave dhe parimeve që rregullojnë shërbimin civil, e ndërlidhur me nenin 86 paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, ku përcaktohet se: “*Organi publik përcakton, në mënyrë të pavarur, llojin dhe shtrirjen e shqyrtimit administrativ, si dhe vlerëson nëse një fakt apo rrethanë është e nevojshme për zgjidhjen e çështjes*”, ka shqyrtuar fillimisht kompetencën dhe autorizimin e organit që ka nxjerr aktin mbi bazën e të cilit ankuesi pretendon së buron e drejta e saj materiale si në ankesë, dhe si rrjedhojë është konstatuar së Akti i emërimit Nr. Nr. 01-112-1257 i datës 19.11.2024, është nxjerrë dhe nënshkruar nga zyrtari publik F.A. në cilësi të ushtruesit të detyrës së Menaxherit të Personelit në Komunën e Prishtinës. Rrjedhimisht, sipas shkresave të lëndës del se zyrtari publik F.A. ka ushtruar këtë detyrë sipas Vendimit 14-112/02-0201950/23 të datës 04.10.2023, të Kryetarit të Komunës së Prishtinës, për periudhën nga data 12.10.2023 deri më 11.04.2024, Vendimit 14-112/02-43522/24, të datës 39.03.2024, të Kryetarit të Komunës së Prishtinës për periudhën nga data 12.04.2024 deri më 11.10.2024, dhe sipas Vendimi 14-112/02-0133832/24 të datës 11.10.2024, të Kryetarit të Komunës së Prishtinës, për periudhën nga data 12.10.2024 deri më 11.04.2025.

Mbi këto rrethana dhe meqenëse akti i emërimit mbi të cilin ankuesi mbështet pretendimet për kompensim është nxjerr nga ushtruesi i detyrës së Menaxherit të Personelit të Komunës së Prishtinës, Kolegji duke u bazuar në nenin 35 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publik (tutje LZP) më të cilin është përcaktuar se: *1. Në rast se një pozitë e nivelit drejtues brenda strukturës organizative të institucionit mbetet e lirë, nëpunësja/i i nivelit të lartë drejtues e atij institucioni e cakton me vendim ushtruesen/in e detyrës për pozitën e lirë. 2. Në pajtim me paragrafin 1. të këtij neni, ushtruesja/i i detyrës mund të caktohet zyrtarja/imë i lartë i kategorisë pasuese, në vartësi të pozitës që caktohet, nga cilado njësi organizative brenda institucionit. 3. Zyrtarja/i publik nuk mund të caktohet si ushtruese/i detyre më gjatë se gjashtë (6) muaj. Kur pozita nuk mund të plotësohet brenda afatit gjashtë (6) muaj, ky afat mund të zgjas më së shumti edhe për gjashtë (6) muaj të tjerë. 4. Pozita e lirë nuk mund të zëvendësohet me ushtrues detyre për më gjatë se*

afati i përcaktuar në paragrafin 3. të këtij neni. 5. Çdo vendim i marrë nga ushtruesja/i i detyrës, pas kalimit të afatit të përcaktuar në paragrafin 3. të këtij neni, është i paligjshëm, konstaton se Komuna e Prishtinës me hyrjen në fuqi të këtij ligji ka qenë e obliguar që caktimin e ushtruesve të detyrës për pozitën drejtuese përkatëse ta bëjë në pajtim me kërkesat ligjore sipas nenit 35 të LZP-së. Andaj, në këtë kontest dhe duke qenë se caktimi i ushtruesit të detyrës së Menaxherit të Personelit të Komunës së Prishtinës, ishte bërë fillimisht më datë 12.10.2023, atëherë, në kuptim të dispozitave të nenit 35 paragrafi 3 të LZP-së caktimi i ushtruesit të detyrës së Menaxherit të Personelit të Komunës së Prishtinës nuk ka mundur të jetë për një periudhë më të gjatë se një (1) vit (6 muaj plus 6 muaj), pra, mbi këtë bazë, zyrtari F.A. ka mundur të ushtroj pozitën e ushtruesit të detyrës së Menaxherit të Personelit të Komunës së Prishtinës vetëm në kohëzgjatje prej një (1) viti, gjegjësisht, vetëm për periudhën kohore 12.10.2023 deri më 11.10.2024 dhe së çdo veprim administrativ pas kësaj periudhë kohore konsiderohet veprim administrativ i ndërmarr nga organi më mungesë të kompetencës ligjore dhe si tillë në kuptim të nenit 52, paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative (LPPA) është akt i paligjshëm.

Lidhur me konstatimet si më lartë, Kolegji mori parasysh qëndrimin e Gjykatës Supreme sipas Aktgjykimit P.A.nr.07/2025, të datës 10.06.2025, rrjedhimisht, në arsyetimin e këtij aktgjykimi Gjykata Supreme ka konstatuar se: *...Nga kjo dispozitë rrjedh qartë se çdo akt juridik i nxjerrë nga një udhëheqës në cilësinë e ushtruesit të detyrës pas skadimit të afatit prej një viti është i pavlefshëm në thelb, për shkak të mungesës së kompetencës ligjore për të ushtruar funksionet që burojnë nga ajo pozitë..... Ligji i referohet pozitës si funksion institucional dhe jo individit si person. Pra, ndërrimi i personit nuk e ndërpret dhe nuk e rifillon afatin gjashtë mujor, përkatësisht njëvjeçar të ushtrimit të përkohshëm të pozitës. Kjo qasje është në përputhje me frymën e ligjit që kërkon stabilitet, profesionalizëm dhe përgjegjësi institucionale në udhëheqjen publike.*

Nisur nga gjendja e fakteve si më lartë, Kolegji vlerëson se nuk janë të bazuara pretendimet ankimore të ankuesit, pasi që, siç u tha më lartë Akt Emërimi me Nr. 01-112-1257 i datës 19.11.2024, është nënshkruar nga personi më mungesë të kompetencës ligjore, dhe si i tillë cilësohet akt i paligjshëm mbi bazën e nenit 52, paragrafi 1, nën paragrafi 1.1 të LPPA-së, kështu që, duke qenë se i njëjti nuk kontestohet me ankesë.

Kolegji vendosi si në dispozitiv të vendimit, duke refuzuar ankesën si të pabazuar dhe detyroj Njësinë e Burimeve Njerëzore të Komunës së Prishtinës që në pajtim me pikëpamjet juridike si në arsyetimin dhe autorizimet ligjor sipas nenit 53, paragrafi 1 të LPPA-së të anuloj Aktin e emërimit Nr. 01-112-1257, të datës 19.11.2024.

Këshillë Juridike: *Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Administrative në Prishtinë- Departamenti për Konteste të Punës, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.*

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
A.nr.2095/2025

Merlinda RAMAJ

Procesmbajtëse

Ardita Haxhnikaj DEMI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Përfaqësueses së autorizuar avokate Myrvete Hashani;
- Organit të Punësimit: Kryetarit të Komunës dhe Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Komunën e Prishtinës, si dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.